

## KONTRATË SHITJE

(Kuotash në Kapitalin Themeltar)

Per kuotat e shoqerise: "OCCHIO VIVO" shpk me NUIS: L82320501J

- SHITËSI:** **Z.Edison Hysenbelli**, i datëlindjes 03/07/1978, lindur në Polican dhe banues në Durres, dhe nr. Personal H80703041S;
- BLERËSI:** **Z. Denis Doda** , i datëlindjes 04/11/1986, lindur në Peshkopi dhe banues në Tiranë, dhe nr. personal I61104044H.
- BLERËSI:** **Z. Angelo Spinoza** i datëlindjes 10/07/1959, lindur ne Gaeta, Itali dhe banues në Durres, dhe nr. personal SPNNG59L10D843R.

Palët, me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar, pasi kanë zhvilluar bisedime paraprake, në mbështetje të Kodit Civil, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Statutin e **Shoqërisë "OCCHIO VIVO" sh.p.k**, ranë dakord të lidhin këtë Kontratë Shitje Kuotash me përmbajtjen si vijon:

### 1. OBJEKTI

1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi **Edison Hysenbelli**, i shet në mënyrë përfundimtare, dhe pa asnjë kusht, blerësit **Z.Denis Doda**, 1 Kuotë që përbën **20%** (Njezetë për qind) dhe **Z.Angelo Spinoza** ,1 Kuote **10%**(Dhjetë për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të **Shoqërisë "OCCHIO VIVO" sh.p.k** person juridik privat i së drejtës shqiptare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) **L82320501J** dhe seli në adresën: Rruga Skenderbej 3, Lagja 1, Durres

### 2. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

2.1 Pronësia 30% të kapitalit të regjistruar të **Shoqërisë "OCCHIO VIVO" sh.p.k** do të kalojë nga pala shitëse **Z.Edison Hysenbelli**, , tek pala blerëse **Z.Denis Doda**, **Z.Angelo**

---

**Spinoza** në momentin e depozitimit të kësaj Kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Çmimi i shitjes do të jete **12000 euro (dymbëdhjetëmijë euro)**. Vlere qe do te paguhet me fondet e kompanisë.

2.3 Nga momenti i depozitimit të Kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse, **Z.Edison Hysenbelli** humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e tij prej **30%** të kapitalit të zotëruar në Shoqëri, dhe këto të drejta fitohen nga blerësi, i cili nga ky moment bëhet pronar: **Z.Denis Doda, me nje kuote prej 50% dhe Z.Angelo Spinoza me 1 kuote 50%** të kapitalit të Shoqërisë **“OCCHIO VIVO” sh.p.k**, me strukturën e pjesëve si vijon:

<b>Ortakët e Shoqërisë</b>	<b>Pjesët e Zotëruara</b>	<b>Përqindja e Kapitalit</b>
<b>Edison Hysenbelli</b>	<b>Ishte 1 kuote, u be 0 kuota</b>	<b>30% u be (0)</b>
<b>Denis Doda</b>	<b>1 kuote</b>	<b>30% u be 50 %</b>
<b>Angelo Spinoza</b>	<b>1 kuote</b>	<b>40% u be 50 %</b>
<b>Totali</b>	<b>2 kuota</b>	<b>100%</b>

### **3. DETYRIMET E SHITËSIT**

Shitësi detyrohet:

1. T'i kalojë Blerësit pronësinë mbi kuotat objekt i kësaj kontrate të lirë nga çdo barrë, sekuestrim dhe detyrime të çfarëdolloj natyre.
2. T'i dorëzojë Blerësit dokumentacionin mbi pronësisë e kuotave që i shet nëpërmjet kësaj kontrate.
3. Të paguajë shpenzimet e regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

### **4. KAPITALI FILLESTAR I SHITËSIT**

1. Shitësi mund dhe duhet të tërheqë pjesën e kapitalit të investuar në kompani me vlerën 18000 euro (tetëmbëdhjete mijë euro) depozituar në llogarinë e kompanisë muajin e themelimit.

### **5. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

5.1 Për këtë Kontratë, do të jenë bazë për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
- Legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare;

- Aktet e tjera ligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë kontratë.

5.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres.

## 6. DISPOZITA TË FUNDIT

6.1 Kontrata u përpilua në 5 (pese) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga një kopje ju jepet palëve, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe një kopje duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë.

### PALËT

**Shitësi**

**Edison HYSENBELLI**



**Blerësi**

**Denis DODA**

**Angelo SPINOSA**

